



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0077127-2/25 dt. 24.12.2025
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Propozim -Vendimin Nr. 01-020/04-0077127/25, dt. 22.12.2025 të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M


(Për Formimin e Komisionit për Thjeshtimin e Shërbimeve Administrative në Komunë)

1. **Formohet** Komisioni për Thjeshtimin e Shërbimeve Administrative në Komunë, në këtë përbërje:
 - 1.1 Beqir Rafuna – Kryetar, (Drejtorja për Administratë të Përgjithshme);
 - 1.2 Sadije Jashari – Anëtare, (Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian);
 - 1.3 Albana Azemi – Anëtare, (Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë).
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë thjeshtimin e shërbimeve administrative në Komunë, duke bërë ofrimin sa më të lehtë të shërbimeve për qytetar, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, e ku është e mundur që këto shërbime të thjeshtohen.
3. Komisioni i lartcekur duhet të bashkëpunojë ngushtë me Drejtorinë Komunale dhe Sektorët që bëjnë ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët lidhur me thjeshtimin e shërbimeve komunale.
4. Komisioni obligohet që të përgatitë Vendim duke specifikuar shërbimet komunale që do të thjeshtohen.
5. Komisioni bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë ofrimin e shërbimeve administrative në institucione.

6. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim, por jo më gjatë se 3 (tre) muaj nga dita e miratimit të tij.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Eaton PEÇI



Shtojcë:

1x1 Propozim -Vendimi Nr. 01-020/04-0077127/25, dt. 22.12.2025 i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

T'i dorëzohet:

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës së Informimit
1x1 Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme
1x1 Drejtorëve të Drejtorive Komunale
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit

